



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 1054/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Samir Mustafa kandidat për asamblenë komunale në Rahovec nga Koalicioni AAK- LDD, paraqitur kundër Edmond Kabashit, për shkak të mungesës së votave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

### V E N D I M

**MIRATOHET** si e bazuar ankesa e Samir Mustafa kandidat për asamblenë komunale në Rahovec nga Koalicioni AAK- LDD.

**URDHËROHET** KQZ që të rinumëroj fletëvotimet në Qendrën e Votimit 1622a dhe 1627a, dhe ky numërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të 3 Nëntorit 2013.

### A R S Y E T I M

PZAP-i me datën 03.12.2013 ka pranuar një ankesë nga Samir Mustafa kandidat për asamblenë komunale në Rahovec nga Koalicioni AAK- LDD, në të cilën pretendon se në qendrën e votimit në Apterush dhe Celinë 1622a dhe 1627a janë bërë shkelje gjatë mbledhjes së rezultateve dhe regjistrimit në procesverbale nga ana e komisionarëve, pasi që sipas parashtruesit të ankesës në këto dy qendra të votimit ka më shumë se 30 vota nga familjarët e tij që e kanë votuar ndërsa i rezultojnë vetëm dy vota. Parashtruesi i ankesës thekson se në këto dy qendra të votimit votat që përkasin atij i janë dhënë kandidatit të subjektit të njëjtë politik konkretisht i janë dhënë Përparim Krasniqit në Apterush dhe Rasim Fazliut në Celinë

PZAP-i pas shqyrtimit dhe analizimit gjeti se:

- **ankesa është e bazuar**

PZAP-i nga shkresat e lëndës të ofruara nga pala ankuese si dhe nga shqyrtimi dhe hetimi i bërë në materialin zgjedhor ka vërejtur se ka paqartësi dhe parregullsi lidhur me rezultatin zgjedhor për këto dy qendra të votimit. PZAP-i në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në këto qendra të votimeve. Andaj nga këto arsye e më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve eventuale të lartë cekura si dhe në mbështetje të 117.4 lidhur me nenin 118.1 dhe 119.5 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
A nr. 1054/2013 më datën 06.12.2013.



**Këshillë Juridik:**

*Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankese në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i*